

# TERMAT E REFERENCËS (TOR)

## TITULLI:

Thirrje për Aplikim për Mbështetje Financiare për OJQ-të në Shërbim të Personave me Aftësi të Kufizuar

## INSTITUCIONI:

Fondacioni "Golden Eagle"

## SHUMA E MBËSHTETJES:

10,000 Euro

## 1. SFONDI

Fondacioni "Golden Eagle" ka një histori të gjatë në mbështetjen e iniciativave që promovojnë përfshirjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuar. Duke synuar të ndihmojë organizatat që punojnë në këtë fushë, Fondacioni shpall thirrjen për mbështetje financiare, duke u fokusuar tek organizatat që veprojnë drejt përmirësimit të jetës së personave me aftësi të kufizuar dhe nxisin përfshirjen e tyre në shoqëri.

## 2. QËLLIMI I MBËSHTETJES

Qëllimi i kësaj thirrjeje është mbështetja financiare e një (1) organizate që ofron shërbime dhe realizon projekte të ndryshme për personat me aftësi të kufizuar. Mbështetja synon të:

- Lehtësojë jetën e personave me aftësi të kufizuar përmes qasjes më të mirë në shërbime, arsim, punësim dhe shëndetësi.
- Promovojë të drejtat dhe përfshirjen e barabartë të personave me aftësi të kufizuar, duke rritur ndërgjegjësimin për aftësitë dhe potencialin e tyre në shoqëri.

## 3. KRITERET E KUALIFIKIMIT

Organizatrat që aplikojnë duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- **Statusi jofitimprurës:** Organizatat duhet të jenë të regjistruara si organizata jofitimprurëse.
- **Përvojë e dokumentuar:** Organizatat duhet të kenë përvojë të konsiderueshme në ofrim të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar dhe në zbatim të projekteve të lidhura me këtë fushëveprim.

- **Kapacitet për zbatim:** Organizatat duhet të dëshmojnë aftësinë për të përdorur mbështetjen financiare në mënyrë efektive për të përmirësuar shërbimet që ofrojnë.

#### 4. KRITERET E PËRZGJEDHJES

Fondacioni "Golden Eagle" do të vlerësojë aplikimet bazuar në kriteret e mëposhtme:

- **Pritshmëritë:** Potenciali i organizatës për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuar.
- **Përshtatshmëria:** Përputhshmëria e aktiviteteve dhe e shërbimeve të organizatës me qëllimet e thirrjes.
- **Nevoja financiare:** Shpjegimi i qartë i nevojës financiare të organizatës dhe mënyrës se si kjo mbështetje do të përdoret për të arritur qëllimet e saj.

#### 5. DOKUMENTACIONI I KËRKUAR

Organizatrat që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- **Përshkrimi i përgjithshëm i organizatës/aktivitetit të organizatës:** Informacion rreth misionit, vizionit dhe aktiviteteve kryesore të organizatës, si dhe përvojën e kaluar në mbështetjen e personave me aftësi të kufizuar.
- **Nevoja financiare:** Një përshkrim i qartë i mënyrës se si do të përdoret mbështetja financiare për të ndihmuar në përmbushjen e qëllimeve të organizatës.
- **Pasqyrat financiare:** Dokumente që tregojnë gjendjen financiare të organizatës, përfshirë pasqyrat financiare për dy vitet e fundit.
- **Dokumentacioni ligjor:** Dëshmi e regjistrimit të organizatës si OJQ ose organizatë jofitimprurëse.

#### 6. SHUMA E FINANCIMIT DHE AFATI I APLIKIMIT

- **Shuma e mbështetjes:** Fondacioni "Golden Eagle" ofron mbështetje financiare në shumën prej **10,000 Euro** për organizatën e përzgjedhur.
- **Afati i aplikimit:** Organizatat duhet të dorëzojnë aplikimet e tyre jo më vonë se më **20 nëntor**.

#### 7. DORËZIMI I APLIKIMEVE

Aplikimet duhet të dërgohen përmes emailit në [fondacioni@goldeneagle-ks.com](mailto:fondacioni@goldeneagle-ks.com) në format PDF. Ju lutemi përfshini të gjitha dokumentet e kërkuara.

Për pyetje ose sqarime të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni:

- **Email:** [fondacioni@goldeneagle-ks.com](mailto:fondacioni@goldeneagle-ks.com)
- **Telefon:** +383(0)44119925

- **Website:** <https://goldeneagle-ks.com/sq/foundation/>